

BE për ekonominë qarkulluese dhe rritjen e gjelbër - Programi rajonal i menaxhimit të mbetjeve (EU4CE - ReWaM)
Duration: 02.10.2023 - 02.10.2028

Countries:
Albania

EU contribution: € 19 000 000

Total budget: € 19 000 000

Implementer:

French Development Agency (AFD), Ministry of Environment (MoE), AKEM Sh.a.


Project description:

Në Shqipëri, menaxhimi i mbetjeve mbetet një sfidë e madhe për cilësinë e jetës, mbrojtjen e ekosistemeve, zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe rritjen e interesit ekonomik e turistik të vendit. Kësisoj, qeveria po i jep përparësi zbatimit efektiv të një sistemi të integruar të menaxhimit të mbetjeve, të bazuar në parimet e ekonomisë qarkulluese. Shqipëria, që nga viti 2014 është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, e cili i nisi zyrtarisht negociatat e anëtarësimit në korrikun e vitit 2022 dhe menaxhimi i mbetjeve është një çështje thelbësore për përafrimin me BE-në, veçanërisht në kuadër të Kapitullit 27 për Mjedisin dhe Ndryshimet Klimatike, i hapur në shtator 2025.

Në kuadër të IPA III, BE-ja i ka deleguar AFD-së menaxhimin e përbërës të investimeve të programit “EU for Circular Economy and Green Growth – Regional Waste Management programme” (EU4CE-ReWaM), i financuar me një grant evropian prej 19 milionë eurosh. Programi zbatohet në dy zona të menaxhimit të mbetjeve, Kukës dhe Gjirokastrë/Vlorë-Jug, dhe përfshin përmirësimin dhe krijimin e infrastrukturës së trajtimit të mbetjeve sipas standardeve të BE-së, si edhe mbylljen e landfilleve jo të përputhshme. Programi është i ndarë në dy faza. Faza 1 përfshin studimet dhe Faza 2 përfshin zbatimin.

Expected results:

- Ulja e vëllimit të mbetjeve të dërguara në landfill;
- Zhvillimi i infrastrukturës për transferimin dhe trajtimin e mbetjeve, në përputhje me standardet evropiane;
- Nxitja e iniciativave të ekonomisë qarkulluese, me fokus të veçantë në rikuperimin dhe riciklimin e plastikës dhe të kartonit;
- Ulja e emetimeve të gazeve serrë dhe ndotësve të tjerë të gjeneruar nga sektori i mbetjeve, përmes mbylljes dhe rehabilitimit të venddepozitimeve, jo në përputhje me standardet dhe ndërtimit të infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e efluentëve të lëngëta dhe të gazta.